

DEKRET
Nr.6272, datë 2.10.2009

PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE PËR KRYETAR KOMUNE NË
KOMUNËN FIERZË

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “gj” dhe 93 të Kushtetutës së Shqipërisë, si dhe të nenit 10, paragrafi 3 të ligjit nr.10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zgjedhjet për kryetar komune në komunën Fierzë, zhvillohen ditën e diel, datë 15 nëntor 2009.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi